

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	8.11.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	10.12.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MIE- Nr. 10
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Enea Karakaçi enea.karakaci@infrastruktura.gov.al Anisa Gjonededaj anisa.gjonededaj@infrastruktura.gov.al Eriona Lala eriona.lala@infrastruktura.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemi në shqyrtim lidhet me realizimin e plotë të autonomisë së OST-së dhe ndarjes ligjore dhe funksionale të OSHEE-së.

Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është person juridik me kapital 100% shtetëror, i licensuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, ku Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si pronar të kësaj shoqërie, sot është Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndërkohë që më parë përfaqësues i Autoritetit Publik ishte ministria përgjegjëse për energjinë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Sipas përcaktimeve të ligjit aktual “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, OST sh.a ka detyrimin e Certifikimit përfundimtar, dhe në kuadër të kësaj procedure kjo shoqëri duhet të paraqesë prova për transferimin e kompetencave nga MIE tek MFE, në cilësinë e aksionerit të OST sh.a.,

Po kështu, sipas përcaktimeve neni 72 të ligjit nr. 43/2015 të datës 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sh.a), synon ndarjen e aktivitetit të shpërndarjes nga aktiviteti i furnizimit. Sipas modelit të ndarjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE sh.a me vendimin nr. 65, datë 19.12.2016 dhe gjithashtu nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë, sot MIE tashme janë krijuar tre kompani bija, të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” si më poshtë:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a me aktivitet “Furnizimin me energji elektrike të

- konsumatorëve fundorë që operojnë në tregun e rregulluar”;
- Furnizuesi i Tregut të Lirë me aktivitet "Blerjen dhe administrimin e energjisë elektrike dhe operimi në tregun e lirë"
 - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a me aktivitet "Shpërndarja e energjisë elektrike, ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

Për të siguruar kërkesën dhe funksionimin e ndarjes ligjore të OSHEE sh.a është e nevojshme të përfshihet krijimi i një programi pajtueshmërie dhe një zyrtari pajtueshmërie përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë, i cili përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

Trasferimi i kompetenca ligjore nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sot në cilësinë e Autoritetit Publik si që Përfaqëson Shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë OST sh.a. për certifikimin Përfundimtar të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”

Krijimi i një programi pajtueshmërie dhe një zyrtari pajtueshmërie përgjegjës për monitorimin e këtij programi si pasojë e ndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në tre kompani bija.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës:

“Opsioni 0” – Ruajtja e “status quo-së”, ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

“Opsioni 1” – Miratimi i një ligji të ri për sektorin e energjisë elektrike.

“Opsioni 2” – Ndryshimi i ligjit ekzistues Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet e opsionit të preferuar janë si vijon:

Ndikimi ekonomik – Ndryshimet e propozuara me ane të përzgjedhjes së opsionit të preferuar, aktualisht nuk shoqërohen me ndikime financiare shtesë në buxhetin e shtetit sepse kemi të bëjmë me ndryshime procedurale.

Ndikim mjedisor – Nuk ka ndikim mjedisor.

Ndikim social – Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë sociale. Nuk ka ndikim në konsumatorët fundorë apo ato në tregun e lirë pasi nuk preken interesat e klientëve, siguria apo cilësia e shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/preferuar është opsioni 2. Opsioni do të mundësojë plotësimin, rishikimin dhe ndarjen e kompetencave dhe roleve të entiteteve të përfshira në proces, të cilat mund të realizohen nëpërmjet miratimit të disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues përkatës të sektorit të energjise elektrike.

Sa më sipër, Opsioni 2 për ndryshimin e ligjit ekzistues “Ndryshimi i ligjit ekzistues Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është përzgjedhur si opsioni i preferuar” pasi ndryshimet e propozuar prekin vetëm disa nene të ligjit aktual të cilat lidhen me aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, dhe jo me ndryshime thelbësore të ligjit.

Përzgjedhja e këtij opsioni do të sigurojë Certifikimin përfundimtar të OST sh.a nëpërmjet transferimit të kompetencave nga MIE tek MFE, në cilësinë e aksionerit të OST sh.a, dhe funksionimin e ndarjes ligjore të OSHEE sh.a nëpërmjet krijimit të një programi pajtueshmërie dhe një zytari pajtueshmërie për të shmangur sjelljet diskriminuese ndërmjet kompanive bija.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
N/A	N/A	N/A

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsye?

Projektligji është finalizuar në tetor 2019 dhe është publikuar për konsultim publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 08.11.2019 me qëllim marrjen e komenteve/rekomandimeve nga ana e palëve të interesuara.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Për zbatimin e opsionit të preferuar ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE),

Zbatimi do të sigurohet nga operatoreët si më poshtë:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Monitorimi do të sigurohet nga institucione shtetërore si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Enti Rregullator i Energjisë

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Shqipëria ka ratifikuar Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë dhe është palë kontraktuese e detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky

Traktat, për këtë arsye është e tepër e rëndësishme marrja e masave për rregullimet e nevojshme në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike.

Ligji Nr. 43/2015 2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ka si qëllim garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është person juridik me kapital 100% shtetëror, i licensuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, ku Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si pronar të kësaj shoqërie, sot është Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndërkohë që më parë përfaqësues i Autoritetit Publik ishte ministria përgjegjëse për energjinë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në përcaktimet e tij parashikon edhe çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit nga Enti Rregullator i Energjisë.

Enti Rregullator i Energjisë, me Vendimin nr. 43, datë 15.03.2017, “*Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a*, ka vendosur çertifikimin e OST sh.a., me disa kushte ku njeri prej tyre përcakton se, OST sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me:

“Bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimi, OST sh.a. do t’i paraqesë ERE-s prova dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme të lidhura me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksioneri i OST sh.a., Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kanë ndodhur janë efektive”.

Po kështu, sipas përcaktimeve nenin 72 të ligjit nr. 43/2015 të datës 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sh.a), synon ndarjen e aktivitetit të shpërndarjes nga aktiviteti i furnizimit. Sipas modelit të ndarjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE sh.a me vendimin nr. 65, datë 19.12.2016 dhe gjithashtu nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë, sot MIE tashme janë krijuar tre kompani bija, të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” si më poshtë:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a me aktivitet “Furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve fundorë që operojnë në tregun e rregulluar”;
- Furnizuesi i Tregut të Lirë me aktivitet “Blerjen dhe administrimin energjisë elektrike dhe operimi në tregun e lirë”
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a me aktivitet “Shpërndarja e energjisë elektrike, ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

Në këtë kuadër, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të krijojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, dhe të sigurojë

që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objekti.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Renditsni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Për të bërë të mundur transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i OST sh.a., Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pasi ushtrimi i kompetencave të mësipërme nga ministria përgjegjëse për energjinë, cënon autonominë e OST-së, si i vetmi entitet përgjegjës për zhvillimin e një sistemi transmetimi të sigurtë dhe eficient, aksionet e së cilin përfaqësohen sot përfaqësohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nepermjet kesaj ndërhyrje do te garantohet automia e kësaj shoqërie.

Të drejtat efektive të vendimmarrjes së operatorit të sistemit të shpërndarjes të pavarur nga ndërmarrja e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes, duke krijuar pavarësi ekonomike-financiare dhe menaxheriale të tij. Ky ndryshim ligjor sjell konceptin e Zyrtarit të pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, si një organ plotësisht të pavarur dhe që ka qasje në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për të përmbushur detyrën e tij.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Trasferimi i kompetencave ligjore nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sot në cilësinë e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë OST sh.a. për certifikimin Përfundimtar të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”

Krijimi i një programi pajtueshmërie dhe një zyrtari pajtueshmërie përgjegjës për monitorimin e këtij programi si pasojë e ndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në tre kompani bija.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

“Opsioni 0” – Ruajtja e “status quo-së”, ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Ligji aktual paraqet pengesa në realizimin e plotë të autonomisë së OST-së dhe ndarjes së OSHEE-së, referuar Vendimit të Entit Rregullator të Energjisë, nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.” në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 pika 6, Direktivës 2009/72/KE mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.

“Opsioni 1” – Miratimi i një ligji të ri. Nuk është vlerësuar i nevojshëm miratimi i një ligji të ri, pasi të gjitha rregullimet që parashikon ligji do të mbeten në fuqi dhe shtesat dhe ndryshimet që propozohen janë në një masë të vogël.

“Opsioni 2” – Ndryshimi i ligjit ekzistues Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Ky është opsioni më i mirë pasi nuk preken ndryshimet thelbësore të ligjit.

Përzgjedhja e opsioneve është mbështetur në vlerësim të karakterit cilësor, pas analizës së të cilit rezultoi se në Opsionin 2 konstatohet një ndikim pozitiv, duke qenë se parashikohet permbushje e kërkesat e ligjit dhe traspozimin e plotë të direktivave duke dhënë garanci për automonitë e operatorëve të siperpërmendur.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*

Ndryshimet e kërkuara lidhen me plotësimin, rishikimin dhe ndarjen e kompetencave dhe roleve të entiteteve të përfshira në proces, nëpërmjet miratimit të disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues përkatës të sektorit të energjisë elektrike ndaj u adresohet vetëm operatorëve të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes si OST sh.a, dhe OSHEE sh.a, si zbatues dhe për të siguruar pavarësinë e tyre për të operuar në këtë sektor dhe ERE, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë në cilësinë e monitoruesve .

- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

Realizimin e certifikimit përfundimtar të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në përputhje me kërkesat ligjore si dhe të drejtat efektive të vendimmarrjes së operatorit të sistemit të shpërndarjes të pavarur nga ndërmarrja e integruar e energjisë elektrike, emërimin e një zyrtari të pajtueshmërisë dhe miratimin e një programi pajtueshmërie.

- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

Plotësimin, rishikimin dhe ndarjen e kompetencave dhe roleve të entiteteve të përfshira në proces, nëpërmjet miratimit të disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues përkatës të sektorit të energjisë elektrike.

Ndryshimet e propozuara me anë të këtij Opsioni nuk kanë ndikim në vlerë monetare, por ndikojnë në plotësimin e kërkesave ligjore lidhur me Certifikimin Përfundimtar të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. dhe emërimin e një zyrtari të pajtueshmërisë dhe miratimin e një programi pajtueshmërie në kuadër të pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, nëpërmjet ndryshimeve të nevojshme ligjore të ligjit ekzistues Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Dhenien e garancisë se autonomisë se këtyre entiteteve, nëpërmjet rritjes se transparencës dhe mirëfunksionimit te tyre.

- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasojë të papritura.*

Risku i mos miratimit të ndryshimeve ligjore do të conte në mosplotësimin e kushteve të certifikimit përfundimtar të OST-së.

- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 2, Ndryshimi i ligjit ekzistues Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Konsiderohet relevant, për situatën konkrete, pasi ndërhyrjet janë vetëm në disa dispozita të tij dhe nuk prek parimet bazë të ligjit. Përzgjedhja e këtij opsioni mundëson adresimin e të gjitha problematikave dhe nevojave për ndërhyrje lidhur me kërkesat ligjore dhe garanci në kuadër të autonomisë së operatorëve.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të përzgjedhur njësitë përgjegjëse do të jenë:

- Ministria përgjegjëse për energjinë
- Operatori i Sistemit të Transmetimit
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
- Enti Rregullator i Energjisë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të zbatimit të opsionit të preferuar do të ndërmarrë masat e nevojshme për:

- ✓ Krijimit të një zyrtari pajtueshmërie
- ✓ Trasferimit të kompetenca ligjore nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Ministria përgjegjëse për energjinë do të ketë rolin kryesor në monitorimin, koordinimin dhe menaxhimin e zbatueshmërisë së këtij ligji, nëpërmjet strukturave përkatëse të saj. Gjithashtu, monitorimi do të jetë një instrument që do të përdoret për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po zbatohen në praktikë sipas specifikimeve përkatëse dhe në të njëjtën kohë do të mbledhë informacionin e nevojshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij ligji. Ky monitorim do të konkretizohet dhe me anë të takimeve ndërmjet MIE-es dhe palëve të përfshira (OSHEE, OST, ERE) në këtë proces, si dhe me përcjelljen nga ana e tyre të raporteve, në të cilat do të pasqyrohen masa e realizimit të secilit objektiv.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

N/A

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

N/A